REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË /A	**09.02.2023**
REFERENCË	
PËR:	**z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan**
CC:	**z. Diamant Bytyqi, Nënkryetar i Komunës në Lipjan** **z. Lulzim Qerimi, Nënkryetar i Komunës në Lipjan**
NGA:	**z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Lipjan**
LËNDA:	**Raport i punës - Muaji Janar 04.01.2023-31.01.2023**

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

DKA edhe gjatë muajit Janar ka realizuar punë dhe aktivitete të ndryshme:

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Më datë **25.01.2023** është bërë nënshkrimi i marrëveshjes mes Komunës së Lipjanit dhe Forumit të Aftësisë së kufizuar për angazhimin e 3-tre asistentëve për nxënësit me nevoja të veqanta.

Nga shkollat fillore është zbatuar vendimi nga MASHT-i **Nr.01 B-453**, i datës **04.10.2022** mbi plotësim ndryshimin e kalendarit shkollor **2022/2023** për zëvendësimin e orëve mësimore ditëve të shtune.

Më datë **27.01.2023** ka përfunduar gjysmëvjetori i parë për nivelet e arsimit parauniversitar, pushimi dimëror ka filluar nga data **30.01.2022** deri më datë **03.02.2022**, ndërsa gjysmëvjetori i dytë ka filluar më datë **06.02.2023**.

Komisioni komunal për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta ka vazhduar me vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla, konform kërkesave nga shkollat.

Konform kërkesës nga MASHT-i kemi dërguar informatat e nevojshme për nxënësit e riatdhesuar nga Komuna e Lipjanit.

Dërgimi i të dhënave në thesar për të gjithë personelin, rreth procesit të klasifikimit i cili për qëllim ka pasur përcaktimin e pagës sipas ligjit të ri.

Kërkesë DPU-së:

- Hartimi i paramasës dhe parallogarisë për: Ndërrimin e kalldajave në shkollat: Shfmu "Ibrahim Banushi" në Shalë dhe "Adem Gllavica" në Lipjan.

Kërkesë DP-së për zhvillimin e procedurës:

- Demolimi, furnizimi, montimi i dyerëve dhe dritareve në disa IEA (kontratë një vjeçare),
- Furnizimi me material higjienik i të gjitha IEA – (kontratë kornizë dy vjeçare),
- Furnizimi me mallrat për mbjelljet pranverë – vjeshtë për periudhën dy vjeçare 2023-2025 (kontratë kornizë),
- Riparimi, pastrimi dhe mbushja e klimave në IEA (kontratë një vjeçare),
- Riparimi i defekteve dhe rregullimi i kulmeve në IEA-të (kontratë kornizë dy vjeçare),
- Furnizimi i gjitha IEA-ve me vegla (pajisje) të ndryshme pune (kontratë dy vjeçare) dhe
- Finalizimi i planit te prokurimit (me shtimin e disa aktiviteve të punës).

Kërkesë buxhetit për:

- Shtim buxheti në kategorinë investime kapitale për projektin: Ndërtimi i parqeve dhe lojërave për fëmijë në shkolla fillore në fshatrat: Dobrajë e Madhe, Kraishtë, Rubovc, Banullë etj.

- Hartimi i planit të rrjedhjes së parasë për vitin 2023 (Janar-dhjetor):

a). Plani i zotimit dhe

b). Plani i shpenzimit

Nënalokimi në kategorinë: paga&mëditje, mallra&shërbime.

Regjistrimi i lëndëve për arkivim.

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe ate:

- Formular për ndryshime–kthim nga lehonia, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit,
- Formular për largim–skadim kontrate, pensionim,
- Formular për punëtor të rinjë,

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.

STATISTIKAT

Gjatë muajit Janar nuk kemi pasur ndonjë statistikë për të paraqitur në raport mujor.

DISKUTIME PUBLIKE (Takime me qytetarë)

- Takim me përfaqësuesit e UNICEF-it rreth vazhdimit të bashkëpunimit për mbështetje të edukatoreve në qendrat me bazë në komunitet në Shalë dhe Magure.
- Takime të ndryshme me qytetarë, përkitazi me çështjet që ndërlidhen me Arsimin dhe
- Takime të vazhdueshme me drejtorët e shkollave.

SFIDAT

- Zvogëlimi i numrit të nxënësve në disa shkolla,
- Risistemimi i punëtorëve arsimor të cilët humbin normat për shkak të zvogëlimit të numrit të nxënësve dhe
- Rritja e numrit të rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla, si pasojë e kësaj komisioni për vlerësimin e këtyre fëmijëve e ka të pamundur t'i vlërësoj të gjithë në kohë reale.

REKOMANDIMET

- Angazhimi i drejtorëve të shkollave për një organizim sa më të mirë të procesit edukativo-arsimor dhe
- Angazhimi i psikologeve në trajtimin e temave me rëndësi për nxënësit në të gjitha shkollat e Komunës.

ÇËSHTJE TJERA

Të gjitha punët e realizuara janë cekur në raport dhe nuk ka ndonjë çështje tjetër për të elaboruar. DKA do të punoj vazhdimisht për krijimin e kushteve sa më të mira në të gjitha shkollat e Komunës sonë, duke menduar gjithmonë më të mirën për të gjithë nxënësit.